



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:273291

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05663373

C. nr. 1106/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit R.I. nga, të cilin me autorizim e përfaqëson Jeton Osmani, avokat nga Prishtina, ndaj kundërpropozueses KEDS dhe KESCO me seli në Prishtinë, rruga “Bulevardi Bill Klinton”, me propozim për sigurimin e provës, para ngritjes së padisë, jashtë seancës gjyqësore, më datën 22.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET propozimi i të autorizuarit të palës propozuese, avokatit Jeton Osmani nga Prishtina, për sigurimin e provës (paraprovës), përmes ekspertizës nga lëmia e elektroenergjetikës.

II. Ekspert caktohet Ylber Zabergja nga Prishtina, ekspert nga lëmia e elektroenergjetikës, i cili ka për detyrë që të konstatoj shkaktarin e dëmit, lëshimet e palëve ndërgjyqëse që kanë kontribuar në dëmin e ndodhur, si dhe të konstatoj vlerën e dëmit, për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike nga kundërpropozuesja dhe për shkak të mos rregullimit të shtyllave elektrike që e furnizojnë familjen e propozuesit me energji elektrike nga e paditura KEDS dhe KESCO me seli në Prishtinë, gjithnjë sipas pretendimeve të palës propozuese, si dhe gjykatës t’i dorëzojë edhe fotodokumentacione në vendin e ngjarjes, dhe ekspertizën e hartuar me shkrim i njëjti ekspert i bujqësisë, **detyrohet t’ia dorëzojë gjykatës në afat prej 7 ditëve, pas daljes në vendin e ngjarjes.**

III. CAKTOHET dalja e Gjykatës dhe e palëve ndërgjyqëse në vendin e ngjarjes, sëbashku me ekspertin nga lëmia e elektroenergjetikës më datë 16.02.2024, në ora 13.30h, në

IV. DETYROHET propozuesi R. I. nga, që t’i paguaj shpenzimet për punën e ekspertit të elektroenergjetikës, të cekur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe atë shumën prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro, në xhirollogarin – arkën e kësaj gjykate, në afat prej 3 (tri) ditëve, pas datës së pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të lëshimit të kësaj prove.

A r s y e t i m

I autorizuari i palës propozuese, avokati Jeton Osmani nga Prishtina, më datën 08.12.2023, në këtë Gjykatë ka parashtruar propozim me shkrim për sigurimin e paraprovës, përmes ekspertizave të gjeodezisë, të bujqësisë dhe të elektroenergjetikës.

Propozimin për sigurimin e paraprovës, para procedurës së rregullt gjyqësore, i autorizuari i palës propozuese, e ka arsyetuar me faktin se deri sa të vendoset për këtë çështje juridike kontestimore,

ka gjasa reale që të zhduken apo të ndryshohen provat nga vendi i ngjarjes në pronën e propozuesit, për shkak të kushteve atmosferike të stinës që po hyjmë, lidhur me dëmet materiale që i janë shkaktuar propozuesit, të pretenduara në propozim. Andaj edhe ka kërkuar sigurimin e paraprovës, përmes ekspertizave të cekura si më lartë.

Gjykata, më datën 12.12.2023, një kopje të propozimit të lartëcekur sëbashku më aktvendimin për pëgjigje në padi, i'a ka dërguar edhe palës kundërpropozuese KEDS dhe KESCO me seli në Prishtinë.

Ndërsa pala kundërpropozuese edhe pse e ka pranuar propozimin e lartëcekur sëbashku me shkresat e lëndës, brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk ka paraqitur përgjigje në propozimin e propozuesit.

Gjykata e shqyrtoj propozimin e të autorizuarit të palës propozuese, për sigurimin e provës, para procedurës së rregullt gjyqësore dhe vlerësojë se i njëjti është i bazuar, se nxjerrja e provës – paraprovës, përmes ekspertizave përkatëse të lartëcekura, do të shërbente në fazat e mëvonshme të procedurës lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, që të vërtetohen saktë dhe në mënyrë objektive faktet relevante të çështjes, ngase duke e pasur parasysh faktin se kemi hyrë në stinën e dimrit, ku pritet edhe të fillojnë lagështitë – rënia e borës, dhe duke e pasur parasysh natyrën e rastit, e posaqërisht duke shtuar edhe faktin se kjo çështje kontestimore nuk është e natyrës urgjente për ty shqyruar, egziston rreziku i humbjes apo zhdukjes së kësaj prove, po që se pritet të merret në procedurën e rregullt gjyqësore, dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj, gjykata duke u bazuar në të lartëcekurat, e konform dispozitave 379 dhe 382 të Ligjit të Procedurën Kontestimore, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendim.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C. nr. 1106/2023, i datës 22.01.2024

G j y q t a r i
Artan Abazi, d. v

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa e veçantë, bazuar në nenin 383.4, të LPK-së.